



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1474/15 prot.

Datë 03.08.2026

V E N D I M

Nr. 930/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Shehu	Kryetar
Gjergj Mersini	Nënkryetar
Edvin Simo	Anëtar
Nertil Kanina	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.08.2026 me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin me pikë të propozimit teknik të ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-76516-02-18-2026 me objekt “Instalimi i sistemit elektronik E-Gate për PKK porti Durrës dhe PKK Porti Sarandë”, me fond limit 137,388,000 (Njëqind e tridhjetë e shtatë milion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë, pa TVSH, ose 1,425,186.72 (Një milion e katërqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy) euro, pa tvsh, zhvilluar në datën 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA..

Skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK” në procedurën e mësipërme të prokurimit, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Shfuqizimi i Vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “INFOSOFT SYSTEMS SHPK & IN CONTINU ET SERVICES SAS” në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me numër reference Nr. REF-76516-02-18-2026, me objekt: “Instalimi i sistemit elektronik E-Gate për PKK porti Durrës dhe PKK Porti Sarandë”, me fond limit 137,388,000 (Njëqind e tridhjetë e shtatë milion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë, pa TVSH ose 1,425,186.72 (Një milion e katërqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy) euro, pa tvsh, zhvilluar në datën 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA.

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Ankimues: Operatori ekonomik “INFOSOFT SYSTEMS” SHPK me NIPT: J61820021C, dhe me adresë: Rruga “Murat Toptani”, Gjergji Center, Tiranë.

Operatori ekonomik “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK me NIPT: K01625001C, dhe me adresë: Rr. "Stanislav Zuber", Nd. 2, H.I9. Njësia administrative Nr. 7, Tiranë.

Subjekte të interesuar: Operatori ekonomik “AlbaScan” SHPK me NIPT: L71416010E, dhe me adresë: Rruga e Kavajës, Objekti “Garden Building“, Kati II, Njësi Bashkiake Nr 10, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatori ekonomik ankimues “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK dhe operatori ekonomik “INFOSOFT SYSTEMS” SHPK kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.5. Ankimuesi “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës, ndërsa operatori ekonomik “INFOSOFT SYSTEMS” SHPK nuk ka plotësuar kushtet formale të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik konkretisht nuk ka respektuar afatet si dhe nuk ka dorëzuar mandat pagesën.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 19-02-2026 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-76516-02-18-2026, me objekt “Instalimi i sistemit elektronik E-Gate për PKK porti Durrës dhe PKK Porti Sarandë”, me fond limit 137,388,000 (Njëqind e tridhjetë e shtatë milion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë, pa TVSH, ose 1,425,186.72 (Një milion e katërqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy) euro, pa tvsh, zhvilluar në datën 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA.

II.2. Në datën 07-04-2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor më datë 21.04.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “PC STORE” SHPK	0 lekë	Skualifikuar
2.BOE “Albascan & Image & Communications Development” SHPK	100,293,240.00 lekë	Kualifikuar
totali i pikëve të marra 285,30		
3.BOE “Infosoft Systems & IN CONTINU ET SERVICES SAS” SHPK	103,240,000.00 lekë	skualifikuar
4. “Communication Progress” SHPK	104,895,000.00 lekë	Kualifikuar
totali i pikëve të marra 282,75		
5.“ TCN” SHPK	109,565,964.90 lekë	Skualifikuar
6.BOE “Novus & Novus Albania” SHPK	114,234,000.00 lekë	Skualifikuar
7.”Dermalog indentification System” Gmbh	115,061,960.32	lekë
Kualifikuar totali i pikëve të marra 169,65		

II.4 Në datën 04-05-2026, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimit e fituesit te procedurës në sistemin e prokurimeve elektronike dhe APP.

II.5. Në datën 13.05.2026 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6648, datë 13.05.2026 dhe numër protokolli nr. 1474/2026, datë 13.05.2026, e operatorit ekonomik “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK në procedurën e prokurimit E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-76516-02-18-2026 me objekt “Instalimi i sistemit elektronik E-Gate për PKK porti Durrës dhe PKK Porti Sarandë”, me fond limit 137,388,000 (Njëqind e tridhjetë e shtatë milion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë, pa TVSH, ose 1,425,186.72 (Një milion e katërqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy) euro, pa tvsh, zhvilluar në datën 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.1474/1 prot, datë 14.05.2026, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga operatori ekonomik “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK dhe nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK”, si dhe lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të

Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK”, në këtë procedurë prokurimi.

II.7. Me anë të shkresës nr.1474/2, datën 19.05.2026 është deklaruar konflikti i interesit të anëtarit A.M të Komisionit të Prokurimit Publik pjesë e trupës gjykuese pas hedhjes së shortit, me përmbajtjen si më poshtë vijon:

“X Vetdeklarim

Vërtetoj se deklaramet e bëra në vijim nga unë janë të plota, të vërteta, të sakta dhe mbaj përgjegjësi ligjore për vertetësinë e tyre.

Me vetëdeklarim nuk do marr pjesë në procesin e vendimarrjes lidhur me ankesën e paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit me të dhënat si më poshtë:

Numri i referencës: me me Nr. REF-76516-02-18-2026 me objekt “Instalimi i sistemit elektronik E-Gate për PKK porti Durrës dhe PKK Porti Sarandë”, me fond limit 137,388,000 (Njëqind e tridhjetë e shtatë milion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë, pa TVSH, ose 1,425,186.72 (Një milion e katërqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy) euro, pa tvsh, zhvilluar në datën 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA.

Autoriteti kontraktues: Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA.

Nr.aplikimi të ankesës online: A/2026/6648, datë 13.05.2026 dhe numër protokollit nr. 1474/2026, datë 13.05.2026.

Data e dorëzimit të deklaratës 19.05.2026.”

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se, janë dorëzuar argumente shtesë/informacion nga operatori ekonomik ankimues “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK, protokolluar me tonën me nr.1474/3 datë 21.05.2026.

II.10. Me anë të shkresës nr.88-26/1, datë 21.05.2026 operatori ekonomik ankimues “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK ka dorëzuar shkresën me objekt “Paraqitje faktesh” e cila është protokolluar pranë nesh me nr.1474/4, datë 22.05.2026.

II.10. Me anë të shkresës nr.88-26/1, datë 21.05.2026 operatori ekonomik ankimues “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK ka dorëzuar shkresën me objekt “Paraqitje faktesh” e cila është protokolluar pranë nesh me nr.1474/4, datë 22.05.2026.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se, është dorëzuar dokumentacion shtesë nga operatori ekonomik ankimues “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK, protokolluar me tonën me nr.1474/5 datë 01.06.2026.

II.10. Me anë të shkresës nr.88-26/3, datë 29.05.2026 operatori ekonomik ankimues “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK ka dorëzuar shkresën me objekt “Paraqitje faktesh” e cila është protokolluar pranë nesh me nr.1474/6, datë 01.06.2026.

II.10. Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, ka përcjellë me shkresën nr. 2226/3 prot., datë 01.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1474/7 prot., datë 03.06.2026, kthim pergjigje dhe sqarim mbi kërkesën e bërë nga operatori ekonomik ankimues “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e kërkesës për dhënien e informacionit dhe dokumentacionit, operatori ekonomik ankimues pasi përbën informacion konfidencial.

II.10. Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, ka përcjellë me shkresën nr. 751/10 prot., datë 25.05.2026, protokolluar me tonën me nr. 1474/8 prot., datë 05.06.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës.

II.11. Me anë të shkresës nr.1474/9, datë 16.06.2026 është dërguar kërkesa për informacion nga Komisioni i Prokurimit Publik tek autoriteti kontraktor konkretisht lidhur me procesverbalin e vlerësimit me pikë të të gjithë ofertuesve pjesmarrës.

II.12. Me shkresën nr. 751/14 prot., datë 23.06.2026, protokolluar me tonën me nr. 1474/10 prot., datë 24.06.2026 është depozituar nga autoriteti kontraktor dokumentacionit me procesverbalin e vlerësimit me pikë të të gjithë ofertuesve pjesmarrës në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.13. Në datë 29.06.2026 është përcjellë qëndrimi juridik i protokolluar me nr.1474/11 i dërguar edhe nëpërmjet postës elektronike i anëtarit K.T të Komisionit të Prokurimit Publik pjesë e trupës gjyquese pas hedhjes së shortit. Referuar shkresës së sipërcituar, rezulton, se ky i fundit ka vendosur mos pranimin e ankesës së sipërcituar.

II.13. Në datë 30.06.2026 është përcjellë shkresa e protokolluar me nr.1474/12, dërguar edhe nëpërmjet postës elektronike i anëtarit Gj.M të Komisionit të Prokurimit Publik pjesë e trupës gjyquese pas hedhjes së shortit. Referuar shkresës së sipërcituar, rezulton, se ky i fundit ka përcjellë kthim pergjigjen ndaj qëndimit të anëtarit K.T të Komisionit të Prokurimit Publik pjesë e trupës gjyquese, në cilësinë e relatorit për pamundesin me daljen e një vendimi themeli deri në atë ditë.

II.9. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se, nuk janë dorëzuar argumente në cilësinë e subjektit të intersuar nga operatorët ekonomik, në përputhje me nenin 113 të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar për procedurën e prokurimit.

II.7. Në datën 22.05.2026 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është protokolluar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6704, datë 22.05.2026 dhe numër protokoll nr. 1601/2026, datë 22.05.2026, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “INFOSOFT SYSTEMS SHPK & IN CONTINUET SERVICES SAS” në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me numër reference Nr. REF-76516-02-18-2026, me objekt: “Instalimi i sistemit elektronik E-Gate për PKK porti Durrës dhe PKK Porti Sarandë”, me fond limit 137,388,000 (Njëqind e tridhjetë e shtatë milion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë, pa TVSH ose 1,425,186.72 (Një milion e katërqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy) euro, pa tvsh, zhvilluar në datën 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 1601/ 1 prot, datë 25.05.2026, me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “INFOSOFT SYSTEMS SHPK & IN CONTINU ET SERVICES SAS”, nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.10. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik, ka përcjellë me shkresën nr. 751/11 prot., datë 01.06.2026, protokolluar me tonën me nr.1601/2 prot., datë 03.06.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “INFOSOFT SYSTEMS SHPK & IN CONTINU ET SERVICES SAS”. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës për shkak të mosplotësimit të kushteve formale. Gjithashtu shkresa me të njëjtën përmbajtje është dorëzuar edhe në rrugë postare protokolluar me tonën me nr.1601/3 datë 03.06.2026.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me ankesën e paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik me A/2026/6704, datë 22.05.2026 dhe numër protokolli nr. 1601/2026, datë 22.05.2026 e operatorit ekonomik “INFOSOFT SYSTEMS SHPK & IN CONTINU ET SERVICES SAS” SHPK, për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitura prej tyre, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1 Në datën 19-02-2026 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-76516-02-18-2026, me objekt “Instalimi i sistemit elektronik E-Gate për PKK porti Durrës dhe PKK Porti Sarandë”, me fond limit 137,388,000 (Njëqind e tridhjetë e shtatë milion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë, pa TVSH, ose 1,425,186.72 (Një milion e katërqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy) euro, pa tvsh, zhvilluar në datën 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA.

III.1.2. Në datën 07-04-2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

III.1.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), autoriteti kontraktor më datë 21.04.2026, ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “PC STORE” SHPK	0 lekë Skualifikuar
2.BOE “Albascan & Image & Communications Development” SHPK	
100,293,240.00 lekë Kualifikuar	totali i pikëve të marra 285,30
3.BOE “Infosoft Systems & IN CONTINU ET SERVICES SAS” SHPK	
103,240,000.00 lekë skualifikuar	
4. “Communication Progress” SHPK	104,895,000.00 lekë Kualifikuar
totali i pikëve të marra 282,75	
5.“ TCN” SHPK	109,565,964.90 lekë Skualifikuar
6.BOE “Novus & Novus Albania” SHPK	114,234,000.00 lekë Skualifikuar
7.”Dermalog indentation System” Gmbh	115,061,960.32 lekë Kualifikuar
totali i pikëve të marra 169,65	

III.1.4. Në datën 04-05-2026, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimit e fituesit te procedurës në sistemin e prokurimeve elektronike dhe APP.

III.1.5. Lidhur me ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomik “INFOSOFT SYSTEMS SHPK & IN CONTINU ET SERVICES SAS” SHPK me nr. A/2026/6704, datë 22.05.2026 dhe numër protokolli nr. 1601/2026, datë 22.05.2026, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të

vlerësimit të ofertave në lidhje mbi skualifikimin e ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “INFOSOFT SYSTEMS SHPK & IN CONTINU ET SERVICES SAS”, nga procedura e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.6. Autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik, ka përcjellë me shkresën nr. 751/11 prot., datë 01.06.2026, protokolluar me tonën me nr.1601/2 prot., datë 03.06.2026, vendimin e KSHA-së, mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “INFOSOFT SYSTEMS SHPK & IN CONTINU ET SERVICES SAS”. Referuar shkresës së sipërcituar të Autoritetit kontraktor, rezulton, se ky i fundit ka vendosur refuzimin e ankesës për shkak të mosplotësimit të kushteve formale. Gjithashtu shkresa me të njëjtën përmbajtje është dorëzuar edhe ne rruge postare protokolluar me tonën me nr.1601/3 datë 03.06.2026.

III.1.7. Neni 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ndryshuar, parashikon se:

“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.

Komisioni i Prokurimit Publik administron të dhënat e Sistemit të Ankesave Elektronike.”

III.1.8. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.9. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen **brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.**

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.10. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.1.11. Neni 112, pikat 1 dhe 2 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikon shprehimisht se: “1. Me regjistrimin e ankesës në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe publikimin e saj nga Komisioni i Prokurimit Publik, Sistemi i Prokurimit Elektronik në ndërveprim me Sistemin e Ankesave Elektronike pezullon në mënyrë automatike vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik me nënshkrim dhe vulë elektronike. Sistemi duhet të zhvillohet duke përdorur teknologji të avancuara të inteligjencës artificiale dhe procese të robotizuara për të kryer pezullimin dhe nxjerrjen nga pezullimi automatik i procedurave të prokurimit.

2. Komisioni i Prokurimit Publik, me marrjen e ankesës në përputhje me këtë ligj, publikon në bazën e të dhënave përmes ndërveprimit me sisteme të treta, të dhënat e mëposhtme:

a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in;

b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës). ”

III.1.12. Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 7 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor për procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar dhe brenda 10 ditëve për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor, të kryera në zbatim të vendimit të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik”.

III.1.13. Në nenin 115 pika 1, “Trajtimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.”

III.1.14. Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar parashikohet se: “Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: “a) të refuzojë ankesën për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj dhe mosrespektimit të afateve të ankimit, sipas parashikimeve të neneve 110 dhe 111 të këtij ligji;”

III.1.15. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për kundërshtimin e vendimit të KVO-së lidhur me vlerësimin/klasifikimin përfundimtar, është 10 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit ose i njoftimit të anulimit. Në rastin konkret operatori ekonomik ankimues BOE “INFOSOFT SYSTEMS SHPK & IN CONTINU ET SERVICES SAS” SHPK, ka dorëzuar në datën 22.05.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, formularin e ankesës së protokolluar me nr. 1601/2026, datë 22.05.2026. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik pas afatit të parashikuar nga neni 110, pika 2 e Ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i cili parashikon se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”, pasi në datën

22.05.2026 (data që operatori ekonomik ankimes ka paraqitur ankesën online), ishte pertej afatit të parashikuar nga ligji. Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, kundër vendimeve të autoritetit kontraktor lidhur me vlerësimin e procedurës së prokurimit, nis nga e nesërmeja e ditës së publikimit të njoftimit të fituesit ose publikimit të njoftimit të anulimit dhe përfundon në ditën e 10-të. Për sa më sipër, ankesa dorëzuar në datën 22.05.2026, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konsiderohet e paraqitur jashtë afatit ligjor të ankimit, duke mos u legjitimuar *ratione temporis*, pas afati i fundit për dorëzimin e saj ka qenë data 14.05.2026. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimes, që të dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dy institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes në sistemin e ankesave elektronike, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit në autoritet kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. KPP, me këtë rast, gjen me vend të theksojë se, ndërsa çdo subjekt i LPP ka të drejtë të interpretojë dispozitat e këtij legjislacioni, po ashtu, këto subjekte kanë edhe detyrimin ta interpretojnë atë në përputhje e harmoni të brendshme dhe të jashtme me legjislacionin tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë por edhe me Kushtetutën si ligji më i lartë në vend referuar parashikimeve të nenit 4/2 të saj. Kushtetuta vetë parashikon hierarkinë, statusin dhe efektin e normave ligjore. Kuadri kushtetues ka parashikuar hierarkine e normave ligjore në nenin 116 të Kushtetutës në të cilin parashikohet se: “1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

a) Kushtetuta;

b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara;

c) ligjet;

ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.

3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre.” Në këtë kuadër Kushtetuta vetë, duke folur për hierarkinë e akteve normative në nenin 116 të saj, parashikon akte normative që janë “nën” ligjet sic është në rastin konkret VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Në këtë mënyrë, duke qenë se ligjet kanë epërsi mbi aktet normative të Këshillit të Ministrave, KPP në vendimarrjen e tij i qëndron strikt këtij rregullimi si organi më i lartë në fushën e prokurimit publik, i cili ka të drejtën dhe përgjegjësinë të bëjë interpretimin përfundimtar të legjislacionit të fushës përkatëse duke llogaritur afatet e ankimit të operatorëve ekonomikë sipas parashikimeve të nenit 110 pika 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

III.1.16. Në nenin 118, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “ *Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimit të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji*”. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve, është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.2. Lidhur me ankesën e paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik me A/2026/6648, datë 13.05.2026 dhe numër protokolli nr. 1474/2026, datë 13.05.2026, e operatorit ekonomik “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK, për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitura nga operatori ekonomik “Albascan Shpk” & “Image & Communications Development Shpk”, me pretendimin se : “*Mospërmbushja e kriterit të veçantë të kualifikimit të vendosur në pikën 2.3.6 Kapaciteti Teknik , nga BOE: OE Albascan Shpk dhe OE Image & Communications Development Shpk Në pikën 2.3.6 të kapacitetit teknik AK ka vendosur si kriter kualifikimi: 2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë propozimin teknik (zgjidhjen teknike) sipas pershkrimit të Shtojces 6- Formulari i Specifikimeve Teknike. Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 Për prokurimin publik , i ndryshuar, dhe nenit 41, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik , i ndryshuar, propozimi Teknik/Zgjidhja teknike shërben për të siguruar që ofrertuesi i kupton kërkesat e formularit të specifikimeve teknike dhe ka një propozim konkret mbi zgjidhjen e zbatimit të kontratës. Ky propozim Teknik do të jetë pjesë e zbatimit të kontratës dhe do të shërbejë që sistemi të implementohet dhe të funksionojë në mënyrë të qëndrueshme, të sigurtë dhe në përputhje me kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Bazuar në kriterin më sipër, si dhe në specifikimet teknike/ TOR, procedura objekt prokurimi lidhet drejtpërdrejtë me implementimin e një infrastrukture kritike për kontrollin kufitar të Republikës së Shqipërisë, e cila do të integrohet me sisteme shtetërore ekzistuese dhe do të trajtojë të dhëna sensitive biometrike, identitare dhe operationale. Për vetë natyrën e saj, kjo procedurë nuk lidhet me furnizimin e pajisjeve standarde IT apo zgjidhjeve të zakonshme komerciale, por me implementimin e një platforme të specializuar Government/Border Security Grade, e projektuar posaçërisht për mjedise me kërkesa shumë të larta sigurie, disponueshmërie dhe besueshmërie operative. Në këtë kuadër, përmbushja reale e kërkesave teknike të përcaktuara në Specifikimet teknike/Termat e Referencës (TOR) përbën një element thelbësor të vlefshmërisë së ofertës dhe të vetë sigursisë funksionale të sistemit që do të implementohet. Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktor ka detyrimin ligjor që të kryejë një verifikim të plotë, substancial dhe të dokumentuar të zgjidhjes teknike të ofertuar nga operatorët ekonomikë të kualifikuar, duke*

garantuar që çdo komponent hardëare, softëare, biometrik dhe infrastrukturor i propozuar të jetë realisht në përputhje me kërkesat e procedurës së prokurimit. Nga analiza e detajuar e kërkesave teknike të TOR-eve rezulton se një pjesë e konsiderueshme e tyre përputhen drejtpërdrejt me karakteristikat dhe kapacitetet e platformave të dedikuara Government/Border Security Grade të prodhuesve ndërkombëtarë të specializuar në Automatic Border Control (ABC/eGate), siç është zgjidhja NEC e paraqitur nga operatori ekonomik Communication Progress Shpk. Konkretisht, zgjidhja NEC përmbush në mënyrë të plotë kërkesa shumë specifike të TOR-eve, ndër të tjera: implementimin e një platforme Automatic Border Controller të dedikuar për aeroporte, porte dhe pika kufitare; verifikimin biometrik facial në kohë reale; ----- funksionalitetet liveness detection dhe anti-spoofing; validimin e dokumenteve biometrike sipas standardeve ICAO 9303; suportin për BAC, PACE dhe EAC; leximin MRZ, RFID/NFC, UV, IR dhe VIZ; integrimet me TIMS, e-Visa, FER dhe Interpol; operimin tërësisht on-premise; komunikimet e sigurta dhe Mutual Authentication; arkitekturën enterprise me High Availability (HA) dhe Disaster Recovery (DR); si dhe funksionimin në mjedise kritike me kërkesa shumë të larta sigurie dhe disponueshmërie. Gjithashtu, kërkesat e TOR-eve për: pajisje rezistente ndaj korrozionit dhe vandalizmit me klasifikim minimal IP54; ----- sensorë anti-tailgating dhe anti-crush kamera biometrike dhe monitorim 360°; funksionim në mjedise portuale me ngarkesë dhe kushte të vështira ambientale; mekanizma tamper detection; auditim të plotë; siguri shumë-shtresore; kontroll aksesit granular, monitorim të log-eve dhe eventeve të sigurisë; infrastrukturë të virtualizuar me HA dhe DR; administrim të mikrosërbyeve dhe container-izimit; si dhe integritet me sisteme kritike shtetërore janë karakteristika që lidhen drejtpërdrejtë me zgjidhje enterprise të nivelit të lartë për kontroll kufitar dhe siguri kombëtare, dhe jo me zgjidhje standarde komerciale të bazuara thjesht në kamera apo identifikim facial bazik. Në këtë kuadër, operatori ekonomik Communication Progress Shpk thekson se zgjidhja e ofertuar prej tij është një platformë e dedikuar për institucione shtetërore dhe sisteme të sigurisë kombëtare, e testuar dhe implementuar në aeroporte dhe pika kufitare ndërkombëtare me volum shumë të lartë pasagjerësh dhe kërkesa ekstremisht të larta sigurie operative. Gjithashtu, vetë DST dhe TOR-et theksojnë se sistemi: trajton të dhëna sensitive biometrike; ---- lidhet drejtpërdrejt me sistemet qendrore të Policisë së Shtetit; kërkon siguri shumë-shtresore; mbrojtje ndaj ndërhyrjeve të paautorizuara; gjurmueshmëri të plotë; si dhe përputhshmëri me standardet ndërkombëtare të sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave biometrike. Pajisjet eGate do të instalohen në pika kufitare dhe përbëjnë praktikisht pika ndarëse të territorit të Republikës së Shqipërisë me territorin e shteteve të tjera. Për rrjedhojë, çdo mosfunksionim, dështim operacional apo manipulim i këtyre sistemeve do të përbënte risk të drejtpërdrejtë për kontrollin kufitar, cenim të sovranitetit territorial dhe potencialisht cenim të sigurisë kombëtare. Pikërisht për këtë arsye, TOR-et kërkojnë zgjidhje me standarde shumë të larta sigurie, disponueshmërie dhe besueshmërie operative, të projektuara posaçërisht për mjedise Government/Border Security Grade Për rrjedhojë, duke marrë në konsideratë nivelin e kërkesave të TOR-eve dhe natyrën kritike të sistemit që lidhet drejtpërdrejt me kontrollin kufitar dhe sigurinë kombëtare, operatori ekonomik ankues ngre dyshime të arsyeshme mbi mënyrën sesi BOE i shpallur fitues pretendon të përmbushë këto kërkesa shumë specifike dhe të avancuara teknike. Në

zbatim të nenit 92, pika 3 të Ligjit nr. 162/2020 Për Prokurimin Publik , Autoriteti Kontraktor ka detyrimin të vlerësojë si të vlefshme vetëm ato oferta që provojnë në mënyrë të plotë dhe të verifikueshme përputhshmërinë me të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale të procedurës së prokurimit. Në të njëjtën kohë, referuar parimeve të transparencës, proporcionalitetit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, Autoriteti Kontraktor duhet të administrojë dhe verifikojë dokumentacion të plotë teknik që provon realisht kapacitetet dhe karakteristikat e zgjidhjes së ofertuar. Në kushtet kur vetë Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar se propozimi teknik/zgjidhja teknike është element thelbësor për implementimin dhe funksionimin e kontratës, vlerësimi i ofertës duhet të mbështetet në prova të qarta, të plota dhe të verifikueshme mbi përmbushjen e çdo kërkesë teknike. Në rastin konkret, nga dokumentacioni i paraqitur nga ofertuesi i kualifikuar i pari nuk evidentohet qartë se operatori ekonomik garanton përmbushjen e plotë të specifikimeve teknike sipas kërkesave të përcaktuara në DST, ndërkohë që Autoriteti Kontraktor ka proceduar me kualifikimin e tij pa një arsyetim të detajuar teknik mbi përputhshmërinë e ofertës. Për sa më sipër, vlerësojmë se Autoriteti Kontraktor nuk ka kryer një verifikim të plotë dhe objektiv të zgjidhjes teknike të operatorit ekonomik të kualifikuar në vend të parë, në përputhje me kërkesat e dokumenteve të tenderit, përkatësisht për elementët si më poshtë: prodhuesin konkret të zgjidhjes së ofertuar, ----- modelet konkrete të pajisjeve eGate dhe komponentëve biometrikë; datasheet-et dhe specifikimet teknike; certifikimet dhe autorizimet nga prodhuesi: parametrat realë të performancës biometrike; eksperiencën reale të implementimit të kësaj zgjidhjeje në aeroporte, porte ose pika kufitare; si dhe mënyrën konkrete të verifikimit të përputhshmërisë së zgjidhjes së ofertuar me kërkesat e TOR-eve. Në shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur nga ofertuesi i kualifikuar i pari, KVO nuk ka mbajtur parasysh faktin se sistemi objekt prokurimi nuk përbën një zgjidhje standarde kamera face recognition , por një platformë kritike Government/Border Security Grade për kontroll kufitar dhe siguri kombëtare, ku çdo komponent teknik, algoritëm biometrik, mekanizëm autentifikimi dhe element sigurie ka impakt të drejtpërdrejtë në integritetin e kontrollit kufitar dhe mbrojtjen e infrastrukturës shtetërore.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën për ndryshimin e dokumentave të tenderit të “Kritereve të Veçanta të Kualifikimit” është shtuar pika 2.3.6 “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi si më poshtë:

“Në Shtojcën 9 “Kriteret e Veçanta për Kualifikim”, në pikën 2.3 “Kapaciteti Teknike”, si dhe në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim shtohet nënpika 2.3.6 me përmbajtjen si më poshtë:

2.3.6 *Operatori Ekonomik duhet të paraqesë propozimin teknik (zgjidhjen teknike) sipas pershkrimit të Shtojcës 6- Formulari i Specifikimeve Teknike.”*

III.2.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK” në përmbushje të kriterit të mësipërm ka paraqitur:

Deklarate_Prodhuesi_Permbushje si dhe Zgjidhje_Teknike_JV_Egate.

III.2.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.2.6. Në nenin 77, pikat 1 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: *“3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*

III.2.7. Në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar,

parashikohet se: 1. Në procedurat e prokurimit për shërbime, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë qartë në termat e referencës, natyrën, objektin, qëllimin, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit që do të kryhet. 2. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve. 6. Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës.

III.2.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.9. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës objekt-ankimi, autoriteti kontraktor në pikën 2.3.6 ka kërkuar shprehimisht që: “Operatori Ekonomik duhet të paraqesë propozimin teknik (zgjidhjen teknike) sipas pershkrimit të Shtojces 6- Formulari i Specifikimeve Teknike.”. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimit elektronik, nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK konstatohet se ky i fundit ka paraqitur dokumentin “Propozimi_Teknik” dhe dokumentin

“Deklarate_Prodhuesi_Permbushje”, në të cilën ka paraqitur projektimi, zhvillimi dhe implementimi i sistemit elektronik Border Controller. Së pari, vlen të theksojmë, se referuar dokumenteve të tenderit, konkretisht Njoftimit të kontratës, pikës 4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se përzgjedhja e fituesit do të bëhet mbi ofertën ekonomike më të favorshme bazuar në kosto duke en darë vlerësimin në shtyllën 1. çmimi 65 pikë dhe shtyllën 2. Kualifikimi dhe kompetencat profesionale të stafit teknik. 0 - 35 pikë, dhe në asnjë rast nuk ka përcaktuar që “Propozimi teknik”, i paraqitur do të kishte një rol të posaçëm në vlerësimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues. Sa më sipër arsyetuar, referuar kriterit të kualifikimit, si dhe argumentimit të ankimuesit në ankesën e tij, KPP nga verifikimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK, konstaton se ky i fundit ka dorëzuar dokumentin “Propozim teknik”, në të cilin pasqyrohen zgjidhja teknike e ofruar. Gjithashtu, referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues në lidhje me kërkesat teknike të përcaktuara në Specifikimet teknike/Termat e Referencës (TOR), të dorëzuara nga operatori ekonomik “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK ky i fundit ka dorëzuar dokumentin Deklarate prodhuesi me specifikimet teknike të përcaktuara. Pra sa më sipër, KPP gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues, në përmbushje të kriterit të kualifikimit në pikën 2.3.6 dhe specifikimeve teknike ka paraqitur dokumentet e kërkuara, në të cilin ka pasqyruar zgjidhjen teknike e cila i përket autoritetit kontraktor si organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi të përcaktojë kriteret e veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike dhe është lënë nën përgjegjësinë e këtij të fundit, të përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vlen të theksojmë, se autoriteti kontraktor edhe pas lidhjes së kontratës, disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht nenin 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenin 36 “Sigurimi i kontratës”, dhe nenin 108 “Raportimi në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale” 22 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 124 “Detyrimet e autoritetit ose entit kontraktor gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, si dhe nenit 36 “Sigurimi i kontratës”, dhe nenit 108 “Raportimi në rastet e mospërmbushjes së detyrimeve kontraktuale” të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Nisur nga pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për mospërmbushjen e kriterit të parashikuar në pikën 2.3.6 nga operatori ekonomik “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK përse i përket zgjidhjes teknike të ofruar, Komisioni pasi verifikoi dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga ky operator

rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur dokumentat si në pikën III.2.3., ndaj kërkesa e autoritetit kontraktor me dokumentacionin e ngarkuar në SPE nga ana e operatorit ekonomik “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK, përmbushet nga ana e këtij të fundit. Në këtë kuadër KPP gjykon, se arsyeja e pretenduar nga ankimuesi për shfuqizimin e vendimit të Komisioni i Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin për operatorin ekonomik BOE “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK nuk qëndron, përse kohë që ky i fundit ka paraqitur dokumentacionin e përcaktuar nga vetë autoriteti kontraktor në DST, me detaje të propozimit teknik të paraqitur në SPE rezultoi se e përmbushë kriterin në fjalë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK, për vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të operatorit ekonomik “Albascan Shpk” & “Image & Communications Development Shpk”, me pretendimin se : *“Metodologjia e gabuar mbi mënyrën e pikëzimit të ofertës së operatorit ekonomik Communication Progress Shpk në raport me BOE i kualifikuar i pari. Në Dokumentet Standarde të Tenderit është përcaktuar në mënyrë eksplicite metodologjia e vlerësimit për kriterin e ofertës ekonomikisht më të favorshme, përmes formulave lineare proporcionale, të cilat janë pjesë detyruese e DST dhe përbëjnë bazën e vetme të llogaritjes së pikëve, konkretisht: 4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X Sipas rëndësisë: 1. 2. çmimi 65 pikë Kualifikimi dhe kompetencat profesionale të stafit teknik. 0 - 35 pikë Argumentimi i kriterëve të pikëzuara dhe mënyra e llogaritjes së pikëve: 1. Çmimi: 65 pikë Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij. Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës: $Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$ Pk1 ____ Pikët e kriterit që vlerësohet Vmink1 ____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet Pmaxk1 ____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet. 2. Kualifikimi dhe kompetencat profesionale të stafit teknik. 0 - 35 pikë Argumentimi: Vlerësimi në pikë për kualifikimin profesional dhe përvojën e stafit teknik është vendosur për të siguruar një diferencim real të cilësisë në një projekt që përfshin instalimin, integrimin dhe konfigurimin e një sistemi elektronik më nivel të lartë kompleksiteti dhe ndjeshmërie sigurie. Përvoja profesionale e stafit përbën një tregues të drejtpërdrejtë të cilësisë së realizimit të kontratës, stabilitetit operacional dhe menaxhimit të riskut teknik gjatë fazave të implementimit të sistemit E-Gate. Stafi teknik i kualifikuar garanton zbatim korrekt të kontratës, integrim të qëndrueshëm të komponentëve hardëare dhe softëare, konfigurim të sigurt të sistemeve dhe menaxhim efektiv të proceseve gjatë gjithë ciklit të implementimit të kontratës. Nga stafi i kërkuar në Kriteret e Vecanta të kualifikimit, pika 2.3.4 NJP gjykon të vendosë si pjesë e vlerësimit me pikë, punonjësit si më poshtë: Në projekte të tilla, roli i Projekt Menaxherit është kyc për menaxhimin sa më të mirë në kohë dhe në cilësi të projektit. Ky punonjës, i certifikuar për këtë qëllim, do të ketë kompetencat për të ndjekur projektin, për të bashkërenduar punën, për të ndërvepruar me AK në lidhje me nevojat dhe problematikat e zbatimit të kontratës. Eksperienca e këtij punonjësi është një element*

kyc që ndikon në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e projektit me cilësi. Në projekte të tilla, roli i specialistit të certifikuar në fushën e sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001 Lead Implementer, ISO/IEC 27001 Lead Auditor, CISM, CISSP ose ekuivalent)- është kyc për menaxhimin sa më të mirë të të dhënave të cilat në këtë projekt janë mjaft sensitive. Kjo për shkak të natyrës së këtij sistemi i cili ka të bëjë drejtpërdrejtë me të dhëna konfidenciale për vetë AK që e zbaton por edhe të tretët. Punonjësi i pajisur me këtë certifikim, është trajnuar për mënyrën sesi këto të dhëna ruhen të sigurt dhe cfarë praktikash ndiqen për këtë qëllim. Eksperienca e këtij punonjësi është një element kyc që ndikon në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e projektit në fushën e sigurisë së të dhënave. Roli i specialist për implementimin dhe konfigurimin e integritetit të sistemit përmes API-ve të sigurt, ëeb services ose mekanizmave të ndërveprimit institucional është kyc për funksionimin e sistemit, i cili për nga natyra ka ndërveprim të disa sistemeve me të dhëna mjaft sensitive të cilat duhet të konfigurohen në mënyrë që sistemi të funksionojë dhe të dhënat të jenë të sigurt. Eksperienca e këtij punonjësi është një element që ndikon në implementimin dhe konfigurimin e të dhënave përmes API-ve të sigurt duke minimizuar risqet dhe për një sukses të ndërveprimit institucional. Detajimi i pikëzimit është si më poshtë: 2.1 a. Kualifikimi dhe përvoja e Menaxherit të Projektit të certifikuar (PMP ose ekuivalent). 0 - 15 pikë, e ndarë: Eksperienca në punë si projekt menaxher në vite 0 - 5 pikë Argumentim: Eksperienca në vite është një element i cili tregon aftësi dhe kompetenca në punë. Përvoja në vite është tregues i drejtpërdrejtë i stabilitetit profesional, aftësisë për të menaxhuar cikle të plota projekti dhe për të përballuar situata komplekse teknike dhe organizative. Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale në shkallë zbritëse, projekt menaxheri me më shumë eksperiencë në vite vlerësohet me pikët maksimale (5 pikë) dhe projekt menaxherët e tjerë sipas formulës. Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara. AK mund të kryejë verifikime. Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. Vlerësimi do të bëhet si më poshtë: Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës: $Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$ $Pk1$ ____ Pikët e kriterit që vlerësohet $Vmink1$ ____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet $Pmaxk1$ ____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet $Ok1$ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet. b. Eksperienca si projekt menxher në projekte në numër 0 - 5 pikë Argumentim: Numri i projekteve në të cilat PM ka marrë pjesë është tregues i rritjes së aftësive dhe kompetencave në punë. Numri i projekteve të menaxhuara përbën tregues konkret të përvojës praktike, duke rritur aftësinë për planifikim efektiv, kontroll të afateve dhe menaxhim të riskut. Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbritëse, në numër projektësh, ku vlerësohet me pikët maksimale PM i cili ka një numër më të lartë projektësh të cilat ka realizuar (5 pikë) dhe në vazhdim PM-të e tjerë sipas formulës. Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara. Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime. Vlerësimi do të bëhet si më poshtë: Pikët për

këtë kriter përlllogariten sipas formulës: $Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$ Pk1 ____ Pikët e kriterit që vlerësohet Vmink1 ____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet Pmaxk1 ____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

c. Ekpserienca si projekt menaxher në vlerë 0 - 5 pikë Argumentim: Vlera e projekteve në të cilat PM ka marrë pjesë është tregues i rritjes së aftësive dhe përgjegjësise në punë. Vlera e projekteve të menaxhuara përbën tregues konkret të përvojës dhe përgjegjësisë duke rritur aftësinë për menaxhim të portofoleve të konsiderueshme dhe projekteve komplekse edhe për shkak të vlerës. Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbritëse, në vlere projektsh, ku vlerësohet me pikët maksimale PM i cili ka një vlere më të lartë projektsh të cilat ka realizuar (5 pikë) dhe në vazhdim PM-të e tjerë sipas formulës. Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara. Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime. Vlerësimi do të bëhet si më poshtë: Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës: $Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$ Pk1 ____ Pikët e kriterit që vlerësohet Vmink1 ____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet Pmaxk1 ____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

2.2 Kualifikimi dhe përvoja Specialistit me certifikim në fushën e sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001 Lead Implementer, ISO/IEC 27001 Lead Auditor, CISM, CISSP ose ekuivalent. 0 - 10 pikë, e ndarë: a. Eksperienca në punë në vite 0 - 5 pikë Argumentim: Eksperienca në vite është një element i cili tregon aftësi dhe kompetenca në punë. Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbritëse, specialisti me më shumë eksperiencë në vite vlerësohet me pikët maksimale (5 pikë) dhe specialistët e tjerë sipas formulës. Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara. Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime. Vlerësimi do të bëhet si më poshtë: Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës: $Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$ Pk1 ____ Pikët e kriterit që vlerësohet Vmink1 ____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet Pmaxk1 ____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b. Eksperienca në projekte të ngjashme në numër 0 - 5 pikë Argumentim: Numri i projekteve në të cilat specialisti ka marrë pjesë është tregues i rritjes së aftësive dhe kompetencave në punë. Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbritëse, në numër projektsh, ku vlerësohet me pikët maksimale specialisti i cili ka një numër më të lartë projektsh të cilat ka realizuar (5 pikë) dhe në vazhdim, specialistët e tjerë sipas formulës. Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara. Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime. Vlerësimi do të bëhet si më poshtë: Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas

formulës: $Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$ $Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet $Vmink1$ _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet $Pmaxk1$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet $Ok1$ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet. Sqarim: Për shkak të natyrës së ndjeshme dhe kompleksitetit teknik të këtij sistemi, realizimi i kontratës kërkon eksperiencë të provuar në projekte që përmbajnë përbërës teknikë dhe karakteristika funksionale të krahasueshme. Me elementë të ngjashëm nënkuptohen komponentët teknikë që karakterizojnë sistemin E Gate, konkretisht instalimi dhe integrimi i sistemeve elektronike të kontrollit të aksesit, pajisjeve biometrike, sistemeve të sigurta të komunikimit, si dhe ndërveprimi hardëare softëare në një arkitekturë të integruar. Me tipologji të ngjashme nënkuptohet natyra e projektit dhe mjedisi i implementimit, pra projekte të realizuara në pika kufitare, porte, aeroporte, institucione shtetërore ose infrastrukturë tjetër kritike, ku kërkohet nivel i lartë sigurie, besueshmërie dhe disponueshmërie e sistemit. Projektet në elementë dhe tipologji të ngjashme tregojnë që specialisti ka realizuar integrim të sistemeve komplekse elektronike, ka operuar në mjedise me protokolle të posaçme sigurie, si dhe eksperiencë në ndërveprim me sisteme ekzistuese dhe databaza. 2.3 Kualifikimi dhe përvoja e specialistit për implementimin dhe konfigurimin e integritit të sistemit përmes API-ve të sigurta, ëeb services ose mekanizmave të ndërveprimit institucional. 0 - 10 pikë, e ndarë: a. Eksperienca në punë në vite 0 - 5 pikë Argumentim: Eksperienca në vite është një element i cili tregon aftësi dhe kompetenca në punë. Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbritëse, specialisti me më shumë eksperiencë në vite vlerësohet me pikët maksimale (5 pikë) dhe specialistët e tjerë sipas formulës. Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara. Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime. Vlerësimi do të bëhet si më poshtë: Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës: $Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$ $Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet $Vmink1$ _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet $Pmaxk1$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet $Ok1$ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet. b. Eksperienca në projekte të ngjashme në vlerë 0 - 5 pikë Argumentim: Vlera e projekteve në të cilat specialisti ka marrë pjesë është tregues i rritjes së aftësive dhe kompetencave në punë. Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbritëse, në vlerë projektesh, ku vlerësohet me pikët maksimale specialisti i cili ka një vlerë më të lartë projektesh të cilat ka realizuar (5 pikë) dhe në vazhdim, specialistët e tjerë sipas formulës. Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara. Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime. Vlerësimi do të bëhet si më poshtë: Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës: $Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$ $Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet $Vmink1$ _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet $Pmaxk1$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet $Ok1$ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet. Në përmbushje të kriterëve të

mësipërme operatori ekonomik Communication Progress Shpk, ka paraqitur dokumentacionin provues për: 1. Menaxher Projekti Blerta Beqiri 14+ vite eksperiencë pune ---- 43+ projekte ICT Vlera totale e projekteve: 2,891,931,901 ALL (~29 milion ?) Projekte kryesore në AKSHI, KPP, DPPSH, Bashkia Tiranë, Banka Certifikime: PRINCE2, ITIL, Microsoft ?? Përmbush maksimalisht kriteret: vite, numër dhe vlerë projektesh 2. Specialistit I certifikuar në fushën e sigurisë së informacionit Besmir Skenderi -- 13+ vite eksperiencë në cybersecurity dhe IT 26+ projekte ICT Vlera totale e projekteve: 796,501,031 ALL (~8.2 milion ?) - ISO/IEC 27001 Lead Auditor - Ekspertizë në: Fortinet, Check Point, Harmony Suite, Safetica, Tenable - Eksperiencë në auditim ISMS, risk assessment, vulnerability management - Projekte në infrastrukturë kritike (OSHEE, ILDKPKI, DPPSH) ?? Përmbush maksimalisht kriteret: vite dhe projekte të ngjashme 3. Specialist API Integration Armir Kacabeti 10+ vite eksperiencë ---- 9+ projekte ICT Vlera totale e projekteve: 1,101,321,308 ALL (~11.3 milion ?) Certifikime: Azure AZ-104, AZ-204, AZ-305 Eksperiencë në REST APIs, OAuth2, OpenID, enterprise integration Projekte me vlerë të konsiderueshme në GovTech dhe Banking Përmbush maksimalisht kriteret: vite dhe vlerë projektesh Bazuar në kriteret e përzgjedhjes së fituesit, bazuar në kosto, AK ka vendosur të vlerësojë në mënyrë proporcionale, duke zbatuar formulën me trend zbritës për çmimin. Formulatat e parashikuara në DST janë mekanizma matematikorë detyrues, që kërkojnë aplikim strikt, pa interpretim diskrecional dhe pa devijim nga parametrat e përcaktuar (Ok1, Vmink1, Vmaxk1 dhe Pmaxk1). Në rezultatin përfundimtar të procedurës konstatohet: Oferta e renditur e parë: 285.30 pikë Oferta e renditur e dytë: 282.75 pikë Diferenca midis tyre: 2.55 pikë Kjo diferencë ka ndikim të drejtpërdrejtë në renditjen përfundimtare dhe në përcaktimin e fituesit të kontratës. Duke qenë se sistemi i vlerësimit është linear dhe proporcional, çdo pikëzim duhet të jetë rezultat i drejtpërdrejtë i aplikimit të formulave të përcaktuara në DST, pasi dokumentacioni i dorëzuar të jetë shqyrtuar në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Diferenca në pikë duhet të reflektojë në mënyrë të saktë diferencën numerike në treguesit përkatës të ofertave, sipas raportit matematikor të parashikuar dhe dokumentacionit provues. Bazuar në mënyrën e vlerësimit në mënyrë proporcionale, metodës së verifikimit dhe dokumentacionit për verifikim, operatori ekonomik Communication Progress Shpk, vlerëson se disponon stafin me kualifikimet më të larta në krahasim me ofertuesin e kualifikuar i pari. Nisur nga fakti se metodologjia e vlerësimit të pikëve për këtë procedurë prokurimi nuk është transparente, pavarësisht kërkesës së subjektit ankimues drejtuar Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara për vënien në dispozicion të dokumentit ku pasqyrohet përllogaritja e pikëve dhe zbatimi i metodologjisë së caktuar, Communication Progress Shpk ngre dyshime për shqyrtimin e gabuar të dokumentacionit provues për BOE i kualifikuar i pari, po ashtu edhe të OE Communication Progress, duke ndikuar kështu një renditje të gabuar. Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga Communication Progress Shpk, nga llogaritjet tona rezulton se KVO ka gabuar në interpretimin e dokumentacionit provues të dorëzuar nga BOE i kualifikuar i pari, dhe nga OE Communication Progress Shpk, si rrjedhojë edhe zbatimi i formulave për këto kritere nuk është bërë në mënyrë të saktë. Çdo devijim nga zbatimi strikt i formulave të miratuara përbën: Shkelje materiale të metodologjisë së vlerësimit; Mosrespektim të dokumenteve të tenderit; Cënim të parimit të barazisë së trajtimit dhe

transparencës; Ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin përfundimtar të procedurës. Në kushtet kur diferenca e pikëve është minimale dhe kriteret janë të strukturuar mbi bazë formule detyruese dhe dokumentacioni provues, kërkohet: Konstatimi i shkeljes në aplikimin e metodologjisë së vlerësimit; Shfuqizimi i vendimit të vlerësimit për pjesën e pikëzimit teknik; Rivlerësimi i ofertave në përputhje të plotë me formulat e përcaktuara në DST, mbështetur në dokumentacion. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të verifikojë dhe vlerësojë ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për tu përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Kualifikimi dhe shpallja fitues paraprak i ofertuesit BOE: OE Albascan Sh.p.k dhe OE Image & Communications Development cënon një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parimin e barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 Për prokurimin publik , të ndryshuar.” , Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit, pika 4.4 e Njoftimit të kontratës “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”, parashikon:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A)¹ Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

- | | |
|---|-------------|
| 1. çmimi | 65 pikë |
| 2. Kualifikimi dhe kompetencat profesionale të stafit teknik. | 0 - 35 pikë |

Argumentimi i kriterëve të pikëzuara dhe mënyra e llogaritjes së pikëve:

- | | |
|-----------|---------|
| 1. Çmimi: | 65 pikë |
|-----------|---------|

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$

$Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

$Vmink1$ _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

$Pmaxk1$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok1$ _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

¹ Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

2. Kualifikimi dhe kompetencat profesionale të stafit teknik.

0 - 35 pikë

Argumentimi: Vlerësimi në pikë për kualifikimin profesional dhe përvojën e stafit teknik është vendosur për të siguruar një diferencim real të cilësisë në një projekt që përfshin instalimin, integrimin dhe konfigurimin e një sistemi elektronik më nivel të lartë kompleksiteti dhe ndjeshmërie sigurie.

Përvoja profesionale e stafit përbën një tregues të drejtpërdrejtë të cilësisë së realizimit të kontratës, stabilitetit operacional dhe menaxhimit të riskut teknik gjatë fazave të implementimit të sistemit E-Gate.

Stafi teknik i kualifikuar garanton zbatim korrekt të kontratës, integrim të qëndrueshëm të komponentëve hardëare dhe softëare, konfigurim të sigurt të sistemeve dhe menaxhim efektiv të proceseve gjatë gjithë ciklit të implementimit të kontratës.

Nga stafi i kërkuar në Kriteret e Vecanta të kualifikimit, pika 2.3.4 NJP gjykon të vendosë si pjesë e vlerësimit me pikë, punonjësit si më poshtë:

Në projekte të tilla, roli i Projekt Menaxherit është kyc për menaxhimin sa më të mirë në kohë dhe në cilësi të projektit. Ky punonjës, i certifikuar për këtë qëllim, do të ketë kompetencat për të ndjekur projektin, për të bashkërenduar punën, për të ndërvepruar me AK në lidhje me nevojat dhe problematikat e zbatimit të kontratës. Eksperienca e këtij punonjësi është një element kyc që ndikon në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e projektit me cilësi.

Në projekte të tilla, roli i specialistit të certifikuar në fushën e sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001 Lead Implementer, ISO/IEC 27001 Lead Auditor, CISM, CISSP ose ekuivalent)- është kyc për menaxhimin sa më të mirë të të dhënave të cilat në këtë projekt janë mjaft sensitive. Kjo për shkak të natyrës së këtij sistemi i cili ka të bëjë drejtpërdrejtë me të dhëna konfidenciale për vetë AK që e zbaton por edhe të tretët. Punonjësi i pajisur me këtë certifikim, është trajnuar për mënyrën sesi këto të dhëna ruhen të sigurta dhe cfarë praktikash ndiqen për këtë qëllim. Eksperienca e këtij punonjësi është një element kyc që ndikon në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e projektit në fushën e sigurisë së të dhënave.

Roli i specialist për implementimin dhe konfigurimin e integritetit të sistemit përmes API-ve të sigurta, ëeb services ose mekanizmave të ndërveprimit institucional eshte kyc per funksionimin e sistemit, i cili për nga natyra ka ndërveprim të disa sistemeve me të dhëna mjaft sensitive të cilat duhet të konfigurohen në mënyrë që sistemi të funksionojë dhe të dhënat të jenë të sigurta. Eksperienca e këtij punonjësi është një element që ndikon në implementimin dhe konfigurimin e të dhënave përmes API-ve të sigurta duke minimizuar risqet dhe për një sukses të ndërveprimit institucional.

Detajimi i pikëzimit është si më poshtë:

2.1 Kualifikimi dhe përvoja e Menaxherit të Projektit të certifikuar (PMP ose ekuivalent). 0 - 15 pikë, e ndarë:

a. Eksperienca në punë si projekt menaxher në vite 0 - 5 pikë

Argumentim: Eksperienca në vite është një element i cili tregon aftësi dhe kompetenca në punë. Përvoja në vite është tregues i drejtpërdrejtë i stabilitetit profesional, aftësisë për të menaxhuar cikle të plota projekti dhe për të përballuar situata komplekse teknike dhe organizative.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale në shkallë zbritëse, projekt menaxheri me më shumë eksperiencë në vite vlerësohet me pikët maksimale (5 pikë) dhe projekt menaxherët e tjerë sipas formulës.

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara. AK mund të kryejë verifikime.

Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$

$Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

$Vmink1$ _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

$Pmaxk1$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok1$ _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b. Eksperienca si projekt menxher në projekte në numër 0 - 5 pikë

Argumentim: Numri i projekteve në të cilat PM ka marrë pjesë është tregues i rritjes së aftësive dhe kompetencave në punë. Numri i projekteve të menaxhuara përbën tregues konkret të përvojës praktike, duke rritur aftësinë për planifikim efektiv, kontroll të afateve dhe menaxhim të riskut.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbritëse, në numër projektsh, ku vlerësohet me pikët maksimale PM i cili ka një numër më të lartë projektsh të cilat ka realizuar (5 pikë) dhe në vazhdim PM-të e tjerë sipas formulës.

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.

Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 _____ *Pikët e kriterit që vlerësohet*

Vmink1 _____ *Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet*

Pmaxk1 _____ *Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet*

Ok1 _____ *Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.*

c. Ekpserienca si projekt menaxher në vlerë

0 - 5 pikë

Argumentim: Vlera e projekteve në të cilat PM ka marrë pjesë është tregues i rritjes së aftësive dhe përgjegjësive në punë. Vlera e projekteve të menaxhuara përbën tregues konkret të përvojës dhe përgjegjësisë duke rritur aftësinë për menaxhim të portofoleve të konsiderueshme dhe projekteve komplekse edhe për shkak të vlerës.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbritëse, në vlere projektsh, ku vlerësohet me pikët maksimale PM i cili ka një vlere më të lartë projektsh të cilat ka realizuar (5 pikë) dhe në vazhdim PM-të e tjerë sipas formulës.

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.

Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 _____ *Pikët e kriterit që vlerësohet*

Vmink1 _____ *Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet*

Pmaxk1 _____ *Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet*

Ok1 _____ *Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.*

2.2 Kualifikimi dhe përvoja Specialistit me certifikim në fushën e sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001 Lead Implementer, ISO/IEC 27001 Lead Auditor, CISM, CISSP ose ekuivalent. 0 - 10 pikë, e ndarë:

a. Eksperienca në punë në vite

0 - 5 pikë

Argumentim: Eksperienca në vite është një element i cili tregon aftësi dhe kompetenca në punë.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbtritëse, specialisti me më shumë eksperiencë në vite vlerësohet me pikët maksimale (5 pikë) dhe specialistët e tjerë sipas formulës.

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.

Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b. Eksperienca në projekte të ngjashme në numër

0 - 5 pikë

Argumentim: Numri i projekteve në të cilat specialisti ka marrë pjesë është tregues i rritjes së aftësive dhe kompetencave në punë.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbritëse, në numër projektsh, ku vlerësohet me pikët maksimale specialisti i cili ka një numër më të lartë projektsh të cilat ka realizuar (5 pikë) dhe në vazhdim, specialistët e tjerë sipas formulës.

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.

Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Sqarim: Për shkak të natyrës së ndjeshme dhe kompleksitetit teknik të këtij sistemi, realizimi i kontratës kërkon eksperiencë të provuar në projekte që përmbajnë përbërës teknikë dhe karakteristika funksionale të krahasueshme.

Me “elementë të ngjashëm” nënkuptohen komponentët teknikë që karakterizojnë sistemin E – Gate, konkretisht instalimi dhe integrimi i sistemeve elektronike të kontrollit të aksesit, pajisjeve biometrike, sistemeve të sigurta të komunikimit, si dhe ndërveprimi hardëare – softëare në një arkitekturë të integruar.

Me “tipologji të ngjashme” nënkuptohet natyra e projektit dhe mjedisi i implementimit, pra projekte të realizuara në pika kufitare, porte, aeroporte, institucione shtetërore ose infrastrukturë tjetër kritike, ku kërkohet nivel i lartë sigurie, besueshmërie dhe disponueshmërie e sistemit.

Projektet në elementë dhe tipologji të ngjashme tregojnë që specialisti ka realizuar integrim të sistemeve komplekse elektronike, ka operuar në mjedise me protokolle të posaçme sigurie, si dhe eksperiencë në ndërveprim me sisteme ekzistuese dhe databaza.

2.3 Kualifikimi dhe përvoja e specialistit për implementimin dhe konfigurimin e integritetit të sistemit përmes API-ve të sigurta, ëeb services ose mekanizmave të ndërveprimit institucional. 0 - 10 pikë, e ndarë:

a. Eksperienca në punë në vite 0 - 5 pikë

Argumentim: Eksperienca në vite është një element i cili tregon aftësi dhe kompetenca në punë.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbtritëse, specialisti me më shumë eksperiencë në vite vlerësohet me pikët maksimale (5 pikë) dhe specialistët e tjerë sipas formulës.

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.

Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

Pmaxk1 _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b. Eksperienca në projekte të ngjashme në vlerë 0 - 5 pikë

Argumentim: Vlera e projekteve në të cilat specialisti ka marrë pjesë është tregues i rritjes së aftësive dhe kompetencave në punë.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale: do të bëhet në shkallë zbtritëse, në vlere projektsh, ku vlerësohet me pikët maksimale specialisti i cili ka një vlere më të lartë projektsh të cilat ka realizuar (5 pikë) dhe në vazhdim, specialistët e tjerë sipas formulës.

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara.

Dokumentacioni për verifikim: Për të vërtetuar eksperiencën në punë dhe projektet e zbatuara duhet të paraqitet CV e detajuar ku të vërtetohet sa më sipër. AK mund të kryejë verifikime.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

$Pk1$ _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

$Vmink1$ _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

$Pmaxk1$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

$Ok1$ _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

III.3.2. Në përmbushje të kriterëve vlerësues për të cilat është përcaktuar dhe pesha specifike, operatori ekonomik “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK” kanë dorëzuar dokumentacionin me emërtimet “Shtojca 10_AS_Egate” si dhe “DEV_Shtojca10_”, ku vërehet “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”, diplomat, Jetëshkrimet dhe kontratat e punës dhe të bashkëpunimit, si më poshtë vijon:

Shtojcën 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqërisë “AlbaScan” SHPK, ku në Pjesën III: “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit”, Seksioni B: “DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’” ka deklaruar, si më poshtë vijon:

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [x] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Shkurt 2026 - xx punonjes Dhjetor 2025- xx punonjes Janar 2026 – xx punonjes Profili i punonjësve: Operatori ekonomik duhet të disponojë stafin e nevojshëm për realizimin e projektimit teknik, instalimit, konfigurimit, integritetit, testimit dhe mirëmbajtjes së sistemit Automatic Border Controller (E-Gate), minimalisht si më poshtë: a) Të paktën 1 (një) Menaxher Projekti i certifikuar (PMP ose ekuivalent), për menaxhimin e projekteve TIK E.G: Prince 2 Foundation in Project Managment Nr.xxxxxx B.M- PMP/PMI Nr. xxxxx
---	---

Emri, Mbiemri z. E.J

Firma _____

Vula _____

Data e dorëzimit të deklaratës _07.04.2026

Shtojcën 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të firmosur dhe vulosur nga

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>
Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Po [x] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Dhjetor 2025- 90 punonjës Janar 2026 – 90 punonjës Shkurt 2026 – 90 punonjës Profili i punonjësve Operatori ekonomik duhet të disponojë stafin e nevojshëm për realizimin e projektimit teknik, instalimit, konfigurimit, integritit, testimit dhe mirëmbajtjes së sistemit Automatic Border Controller (E-Gate), minimalisht si më poshtë:

Image & Communications Development shpk NIPT: 1015110270

administratori i shoqërisë “Image & Communications Development” SHPK, ku në Pjesën III:

“Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit”, Seksioni B: “DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)’” ka deklaruar, si më poshtë vijon:

	a) Të paktën 1 (një) Menaxher Projekti i certifikuar (PMP ose ekuivalent), për menaxhimin e projekteve TIK – Certifikuar PMP nga b) Te paktën 3 inxhinierë IT Inxhinieri informatike, rranes g) Të paktën 1 (një) specialist për zhvillimin ose përshtatjen e komponentëve software server-side të sistemit. ifikuar nga Microsoft MSCD cionesh .NET dhe Programim Certifikuar nga Microsoft per Certifikuar nga Oracle OCP Certifikuar nga Oracle OCA h) Të paktën 1 (një) specialist për implementimin dhe konfigurimin e integritetit të sistemit përmes API-ve të sigurta, web services ose mekanizmave të ndërveprimit institucional. Certified Secure API Integration Specialist Certifikuar nga Microsoft per zhvillim Microsoft Azure dhe Web Service Certifikuar nga Microsoft per zhvillim Microsoft Azure dhe Web Service i) Të paktën 2 (dy) specialistë për mirëmbajtjen e sistemit dhe menaxhimin e incidenteve gjatë periudhës së kontratës, në përputhje me kërkesat për SLA. – Certifikuar me ITIL Foundation Certificate me nr.
--	--

PMP

- *Jetëshkrim (CV-i) të z. M.S ku deklaron eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:*

Vite:..2019 – Certifikuar si PMP.

Në përmbushje të kriterëve vleresuese për të cilat është përcaktuar dhe pesha specifike, OE “Communication Progress SHPK” ka dorëzuar dokumentacionin me emërtimet “Shtojca_10_Formulari_Përmbledhes_i_Vetedeclarimi.”, ku vërehet “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”, Jetëshkrimet si më poshtë vijon:

Shtojcën 10 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” të firmosur dhe vulosur nga administratori i shoqërisë “Communication Progress” SHPK, ku në Pjesën III: “Kriteret e përzgjedhjes/kualifikimit”, Seksioni B: “DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohet)’” ka deklaruar, si më poshtë vijon:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>
Unë kam punonjës të nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: 61 (Vërtetim Nr. [] datë [] Drejtoria Rajonale e Tatimeve Tiranë DTM)
	Profili i punonjësve PIKA 2.3.4 Kapaciteti teknik: a. Të paktën 1 (një) Menaxher Projekti i certifikuar (PMP ose ekuivalent), për menaxhimin e projekteve TIK [] profili Informatikë; Informatikë biznesi, me Diplomë Master [] .12.2012, Bachelor Nr.1833 datë 16.01.2012, në këtë procedurë i deklaruar “Menaxher Projekti TIK” me Certifikatë GF [] datë 27 Mars 2026, lëshuar nga PeopleCert (Prince2).

PMP

- Jetëshkrim (CV-i) të znj. B.B ku deklaron eksperiencat në punë, si më poshtë vijon:

Vite:. 27 Mars 2026 – Certifikuar si PMP.

III.3.3. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se :

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.3.4. Në nenin 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Elementi i koston, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.

III.3.5. Në nenin 88 “Llogaritja e koston gjatë ciklit jetësor” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Llogaritja e koston gjatë ciklit jetësor mbulon, nëse është e mundur, të gjitha ose një pjesë të kostove të mëposhtme përgjatë ciklit jetësor të një produkti, shërbimi ose të punëve:

a) kostot që mbulohen nga autoriteti ose enti kontraktor ose nga përdorues të tjerë, si:

i. kostot që lidhen me blerjen;

ii. kostot e përdorimit, siç janë konsumi i energjisë dhe burime të tjera;

iii. kostot e mirëmbajtjes;

iv. kostot në fund të kohës së përdorimit, si kostot për grumbullim dhe riciklim.

b) kostot mbi efektet mjedisore dytësore që lidhen me produktin, shërbimin ose punët gjatë ciklit të tyre jetësor, me kusht që vlera e tyre monetare të mund të përcaktohet dhe të verifikohet. Këto kosto mund të përfshijnë koston e emetimit të gazeve me efekt serë dhe emetimeve të ndotësve të tjerë dhe kosto të tjera për zbutjen e ndryshimit klimatik.

2. Kur autoritetet ose entet kontraktore i vlerësojnë kostot duke përdorur metodën për llogaritjen e kostove të ciklit jetësor, ato përcaktojnë në dokumentet e tenderit të dhënat që duhet të ofrohen nga ofertuesit dhe metodën që do të përdorë autoriteti ose enti kontraktor për të përcaktuar kostot e ciklit jetësor, mbi bazën e këtyre të dhënave.

Metoda që përdoret për të llogaritur kostot mbi efektet mjedisore anësore duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

a) bazohet mbi kriteret objektivisht të verifikueshme dhe jodiskriminuese.

- b) nëse nuk është krijuar për t'u zbatuar në mënyrë të përsëritur ose të vazhdueshme, metoda nuk favorizon ose diskriminon në mënyrë të padrejtë disa operatorë ekonomikë;
- c) është e aksesueshme për të gjitha palët e interesuara;
- ç) të dhënat e kërkuara mund të sigurohen pa vështirësi nga operatorët ekonomikë.

III.3.6. Neni 47 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përlllogaritet bazuar në:

a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletinin e Njoftimeve Publike;

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës .

3. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.

4. Në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose

c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

5. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

III.3.7. Referuar përcaktimeve ligjore të sipërcituara, autoritetit kontraktor i është lënë në diskrecion që të zgjedhë ndërmjet dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të çmimit ose në bazë të kostos. Në rastin e dhënies së kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kostos, në mbështetje të përcaktimeve ligjore të mësipërme, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dy kategori kriteresh, të cilat janë kriteret e kualifikimit dhe kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Komisioni thekson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Kriteret e kualifikimit vendosen për të garantuar që një ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale, burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kriteret e kualifikimit e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Ndërsa në rastin e kriterëve për shpalljen e kontratës fituese, këto të fundit i shërbejnë autoritetit kontraktor për të përzgjedhur ofertën më të mirë në raportin çmim-cilësi, të cilat detyrimisht duhet të lidhen me objektin e kontratës në fjalë, në bazë të cilësisë, aspekteve mjedisore dhe/ose sociale.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese, atë të *Ofertës ekonomikisht më të favorshme, bazuar në kosto*, vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë

duhet ti nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar, mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes mbi kriterin e kërkuar.

KPP nga shqyrtimi dhe verifikimi i të gjitha Formulave të vetëdeklarimit dhe të CV-ve të sipërcituara, gjen me vend të ndalet në një sqarim paraprak mbi Menaxheret e Projektit të certifikuar (PMP ose ekuivalent) të cilet janë kërkuar nga autoriteti kontraktor konkretisht në pikën 2.3.4 të kriterëve të vecanta a) të paktën 1(një) Menaxher të Projektit të certifikuar (PMP ose ekuivalent), për menaxhimin e projekteve TIK, të cilet janë deklaruar nga operatorët ekonomik pjesmarrës mbi një, që në shqyrtim u morën Cv-të prej të cilëve identifikoheshin komponentët e kërkuar, vitet e eksperiencës si PMP, numri i projekteve dhe vlera e projekteve të ngarkuara në sistemin e prokurimit elektronik, konkretisht si më poshtë:

- Për BOE “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK, Menaxher të Projektit të certifikuar (PMP ose ekuivalent), znj. M.S si e certifikuar PMP, dhe me të gjithë komponentet e identifikueshem në krahasim me 2 PMP e tjera të deklaruar nga BOE “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK. Nga verifikimi i CV-së rezulton se **znj. M.S është certifikuar në 2019 si PMP.**

- Menaxher të Projektit të certifikuar (PMP ose ekuivalent, për OE “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK, znj. B.B si e certifikuar PMP, dhe e vetmja PMP e deklaruar nga OE “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK. Nga verifikimi i CV-së rezulton se **znj. B.B është certifikuar në Mars të 2026 si PMP.**

Komisioni i Prokurimit Publik në analizë të dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimes “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK dhe BOE “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK”, në procedurën e prokurimit objekt ankimi, konstaton se në lidhje me komponentin e dytë konkretisht **“Kualifikimi dhe kompetencat profesionale të stafit teknik”**, kanë paraqitur formularin dhe CV si në pikën III.3.2 të këtij vendimi. Lidhur me eksperiencën në punë si projekt menaxher në vite, Komisioni i Prokurimit Publik e gjen të pazbatueshme formulën e kërkuar nga autoriteti kontraktor për **OE “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK**, pasi znj. B.B si e certifikuar PMP, dhe e vetmja PMP e deklaruar nga OE “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK, nga verifikimi i CV-së rezulton se është certifikuar në Mars të 2026 si PMP duke sjellë kështu 0 pike në eksperiencë në punë si projekt menaxher në vite pasi certifikimi PMP është marrë vetëm pak ditë para hapjes së procedurës, gjithashtu dhe eksperiencë si projekt menaxher në numër projektesh rezulton 0 ashtu si dhe eksperiencë si projekt menaxher në vlerë projektesh me 0 pikë, duke qënë se vetë certifikimi i marrë është pak ditë para hapjes së procedurës dhe nuk arrin të përmbushet asnjë prej nën komponentëve të ndarë të pikës **„1.1 Kualifikimi dhe përvoja e Menaxherit të Projektit të certifikuar (PMP ose ekuivalent“**). Për sa i përket BOE “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK, nga deklaratimet e cituara në pikën III.3.2 të këtij vendimi ka paraqitur znj. M.S si e certifikuar PMP, dhe

me të gjithë komponentët e identifikueshem në krahasim me 2 PMP e tjera të deklaruara nga BOE “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK, ku nga verifikimi i CV-së rezulton se është certifikuar në 2019 si PMP. Ashtu sic dhe cituar në kriterin e vendosur nga vetë autoriteti kontraktor të cituar dhe në piken III.3.1. të këtij vendimi **“kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale në shkallë zbtritëse, projekt menaxheri me më shumë eksperiencë në vite vlerësohet me pikët maksimale (5 pikë) dhe projekt menaxherët e tjerë sipas formulës”**, PMP e deklaruar nga BOE “AlbaScan SHPK & Image & Communications Development SHPK do të marrë pikët maksimale të dhëna për këtë komponent Kualifikimi dhe përvoja e Menaxherit të Projektit të certifikuar (PMP ose ekuivalent) 15 pikë.

Lidhur me vlerësimin e komponentëve të tjerë **“specialistit për implementimin dhe konfigurimin e integritetit të sistemit përmes API-ve të sigurta”** si dhe **“Specialistit me certifikim në fushën e sigurisë së informacionit ISO/IEC 27001 Lead Implementer, ISO/IEC 27001 Lead Auditor, CISM, CISSP ose ekuivalent”**, nga përlllogaritja e pikëve për secilin ofertues të kualifikuar në këtë procedurë prokurimi objekt ankimi, në bazë të formulës së përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentet standarde të tenderit, për sa kohë procedura e prokurimit objekt ankimi do të riveleshet dhe diferenca në pikë e bërë në komponentin e **“Menaxherit të Projektit të certifikuar (PMP ose ekuivalent)”** është përcaktuese e totalit të pikëve rrjedhimisht vlerësimi për komponentet e tjerë mbetet pa ndryshim mbi gjendjen faktike të pikëzimit total.

Në lidhje me këtë pikë pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik ankimues “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK, mbi *“pasaktësinë materiale në publikimin e njoftimit të renditjes paraprake Referuar njoftimit të fituesit/renditjes paraprake të publikuar nga Autoriteti Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqendruara, konstatohet ekzistenca e një pasaktësie materiale dhe kontradiktore në publikimin e pikëve totale të operatorit ekonomik të shpallur fitues, konkretisht BOE Albascan sh.p.k. & Image & Communications Development sh.p.k. Konkretisht, në njoftimin e publikuar, rezultati total i këtij operatori ekonomik është paraqitur: ? në formë numerike si 285.30 pikë; ? ndërsa në formë të shkruar me fjalë si dyqind e tre pikë dyzet , që korrespondon me vlerën 203.40 pikë. Kjo mospërputhje përbën një pasaktësi materiale me ndikim të drejtpërdrejtë në rezultatin e procedurës, pasi diferenca ndërmjet vlerës 285.30 dhe 203.40 është substanciale dhe ndikon drejtpërdrejtë në renditjen finale të operatorëve ekonomikë. Gjithashtu, rezulton se kjo problematikë evidentohet vetëm për operatorin ekonomik të shpallur fitues, ndërkohë që për operatorët e tjerë ekonomikë nuk konstatohet e njëjta mospërputhje në publikimin e rezultateve. Për më tepër, referuar parimeve të së drejtës administrative dhe praktikës së interpretimit të akteve administrative, në rastet kur ekziston mospërputhje ndërmjet vlerës së shprehur numerikisht dhe asaj të shprehur me fjalë, prevalon vlera e shprehur me fjalë, për sa kohë kjo konsiderohet forma më e qartë dhe më pak e ekspozuar ndaj gabimeve materiale të shkrimit. Në këtë kuadër, mospërputhja e konstatuar krijon dyshime të arsyeshme mbi: saktësinë e procesit të përlllogaritjes*

së rezultateve; ? ? ? korrektësinë e publikimit të renditjes paraprake; integritetin e procesit të vlerësimit; si dhe transparencën dhe besueshmërinë e rezultatit final të procedurës së prokurimit.”, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se referuar nenit 92, pika 1 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se “1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave [...]”, si edhe referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, autoriteti kontraktor por edhe operatori ekonomik në rastin konkret nëse do të kishte dyshime apo do të ishte i paqartë kishte të drejtë që të kërkonte sqarime apo të bënte verifikimet përkatëse, edhe nëpërmjet dokumentave të tjerë prej autoritetit kontraktor në mënyrë që të sqarohej mbi vlerësimin e saktë dhe gabimin material. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, kemi të bëjmë me shumë me kërkesë për sqarim për të cilin autoriteti kontraktor e ka sqaruar dhe nëpërmjet vendimit nr.81/2026 datë 22.05.2026 që qartazi është një gabim material dhe redaktimi i cili nuk do të ndikoj në rezultatin numerik të pikëve të evidentuara qartë në SPE.

Sa më sipër komisioni gjykon se ky sqarim është ezauruar në vendimin nr.81/2026 datë 22.05.2026 të KSHA-së.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Infosoft System” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-76516-02-18-2026 me objekt “Instalimi i sistemit elektronik E-Gate për PKK porti Durrës dhe PKK Porti Sarandë”, me fond limit 137,388,000 (Njëqind e tridhjetë e shtatë milion e treqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë, pa TVSH, ose 1,425,186.72 (Një milion e katërqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë pikë shtatëdhjetë e dy) euro, pa tvsh, zhvilluar në datën 07.04.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SHA.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur operatorit ekonomik “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kalimin në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “COMMUNICATION PROGRESS” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Gjergj Mersini

Anëtar
Edvin Simo

Anëtar
Nertil Kanina

Kryetar
Ismail Shehu